



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 12.4.2023

Nr: 328

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**VERIFIKIMIN E TË DHËNAVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË SUBJEKTIT  
VETËDEKLARUES Z. ERTOR NDUE NDREU, KANDIDAT PËR ANËTAR NË KËSHILLIN BASHKIAK I  
PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA DEMOKRATIKE", PËR BASHKINË MIRDITË**

Sot më datë 12.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

**Objekt:** Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ertor Ndue Ndreu, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për Bashkinë Mirditë.

**Baza ligjore:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenet 5 dhe 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreut II, III, V, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**VËREJ:**

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi

Data: 12.4.2023 Nr: 328  
Ora: 12:00



"Për verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të subjektit vetëdeklarues z. Ertor Ndue Ndreu, kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Demokratike", për Bashkinë Mirditë".

kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe kandidati për kryetar bashkie apo anëtarë në këshillat bashkiak.

Me vendim të KZAZ-së, z. Ertor Ndue Ndreu, është regjistruar si kandidat për anëtar në këshillin bashkiak, i mbështetur nga Partia Demokratike, Bashkia Mirditë.

Për këtë kandidat në datën 3.4.2023, pranë Komisionit Qendror i Zgjedhjeve është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik LE-PDSH-21339. Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPGJ).

Në përgjigje të kësaj kërkesë të KQZ-së, DPGJ informon se kandidati në fjalë nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Ertor Ndue Ndreu, rezulton:

- Në rubrikën I. “TË DHËNA PERSONALE”, PIKA B, “Gjenealitete të mëparshme” të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar se ka ndryshim tek gjenealitetet e tij; Emri i mëparshëm: Mentor, Emri i mëparshëm: Marko.
- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1 “A jeni dënuar ndonjë herë me vendim gjyqësor të formës së prerë”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”; Nga Gjykata e Athinës ne vitin 2004 është dënuar me 4 vite e gjashtë muaj burg për veprën penale: Plagosje e lehtë në bashkëpunim.
- Pyetjes 3 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoriteti i huaj, për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”; Nga Gjykata e Athinës ne vitin 2004 është dënuar me 4 vite e gjashtë muaj burg për veprën penale: Plagosje e lehtë në bashkëpunim.
- Pyetjes 4 “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”; Nga Gjykata e Athinës ne vitin 2004 është dënuar me 4 vite e gjashtë muaj burg për veprën penale: Plagosje e lehtë në bashkëpunim.
- Pyetjes 5 “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “PO”; Arrest me burg nga Gjykata Greke.
- Pyetjes 7 “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Është marrë masa e dëbimit për afatin kohor 10 vite Ekspuls pas dënimit nga gjykata. {Periudha 2004-2014}
- Pyetjes 8 “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Nga viti 1998 deri më 2004 ka qëndruar ne Greqi ku ka shkuar për arsye pune.

Në vlerësim të përmbajtjes së deklarimeve si më sipër në formular, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çmon se është e nevojshme marrja e informacioneve shtesë në lidhje me faktet që lidhen me autoritete dhe vende të huaja. Në nenin 2, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se për vepra penale të kryera jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka kompetencën për të kryer verifikime.

Referuar nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 3, shkronja “b/ii”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015, është Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit, që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

#### **V E N D O S:**

1. Kryerjen e verifikimit të thelluar të subjektit vetëdeklarues z. Ertor Ndue Ndreu kandidat për anëtar në këshillin bashkiak i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike”, për Bashkinë Mirditë dhe dërgimin e të dhënave përkatëse Prokurorisë së Përgjithshme për vlerësim të mëtejshëm.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**